

Përshkrimi i aktiviteteve të zhvilluara në Këndin Amerikan

1. Ambasadorët e Natyrës është një grup i cili përfshin moshën nga 14-18 vjeç. Zhvillohet çdo të martë nga ora 17:30-18:30. Pjesëmarrësit diskutojnë tema të ndryshme mjedisore si dhe janë të angazhuar në aktivitete në natyrë, si: mbledhja e mbeturinave, pastrimi i bregdetit. Po ashtu janë të angazhuar edhe në aktivitete të ndryshme sociale si: leximi i librave, mësimdhënia e gjuhës angleze për fëmijët me aftësi të ndryshme.

2. Klubi i teknologjisë është një program shumë i suksesshëm për vajzat e moshave 13-17 vjeç të cilat janë të përfshira në krijimin e aplikacioneve sociale, si dhe kanë marrë pjesë në gara ndërkombëtare. Gjatë çdo sesioni të ri vajzat mblidhen dhe vendosin se cili aplikacion social mund të jetë më i nevojshëm dhe nën drejtimin e stafit të IT-së së Ambasadës Amerikane, së bashku me vullnetarët e korpusit të paqes, punojnë për ndërtimin e aplikacionit.

3. Klubi i Librit për Vajza përfshin vajzat e moshave 16-20 vjeç që takohen një herë në dy javë në Këndin Amerikan. Diskutojnë për librin të cilin kanë përzgjedhur. Librat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe mundësohen nga Zyra e Informacionit e Ambasadës Amerikane.

4. Cdo të hënë në orën 17:00 lexuesit e Këndit Amerikan mund të shijojnë “Orët e filmit”. Filmat janë nga më të njohurit e kinemasë hollivudiane dhe kinematografisë amerikane. Këta filma janë pjesë e koleksionit të DVD-ve që ndodhen në Këndin Amerikan.

5. Klubi i Lexuesve të Vegjël është një aktivitet që zhvillohet çdo të enjte në ambientet e Këndit Amerikan për fëmijët e grup moshës 6 - 11 vjeç. Fëmijëve u lexohet një libër, u mësohet gjuha angleze nëpërmjet këngëve, filmave dhe videove të shfaqura në ekran.

6. Klubi i Artit zhvillohet çdo të shtunë. Fëmijëve u lexohet një libër në përputhje me moshën e tyre dhe më pas krijohet personazhi kryesor i librit me mjete të riciklueshme dhe letra me ngjyra.